



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.936/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhomat e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin individual Krenar Berisha, në çështjen juridike përmbare të kreditorit Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, lagjja Kalabria, rr.“Rexhep Krasniqi”, kundër debitorit N.T.SH. “Gentonisi-B.M. B.I.” me seli në Junik-Deçan, me bazë juridike përmbare, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale-Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2160/2022 të datës 31.03.2023, me datë 30.01.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit N.T.SH. Gentonisi-B.M. B.I. me seli në Junik-Deçan, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale-Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.2160/2022 i datës 31.03.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale-Dhomat e Shkallës së Dytë, Departamenti për Çështje Ekonomike, në rirpcedurë, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.2160/2022 të datës 31.03.2023, ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit të përmbaremit N.T.SH. Gentonisi – B.M. B.I., me seli në Junik - Deçan, të ushtruar kundër urdhrin për lejimin e përmbaremit P.nr.222/2020 të datës 14.08.2020 të lejuar nga përmbareuesi privat Kushtrim M. Musa me seli në Gjilan.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ankesë ka paraqitur debitori për shkak të aplikimit të gabuar të dispozitave të LPP-së dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa, aktvendimi i ankimuar të prishet dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

Përgjigje në ankesë nuk ka paraqitur kreditori.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, përmes gjyqtarit individual, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e ankimuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 194 e 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), e lidhur me nenin 3 paragrafi 2 dhe nenin 17 të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbaremore (LPP) dhe gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori Dogana e Kosovës, me seli në Prishtinë, lagjja Kalabria, rr.“Rexhep Krasniqi”, me datë 14.08.2020, ka paraqitur propozim për përmbaerim kundër debitorit N.T.SH. “Gentonisi” me seli në Junik, në bazë të dokumentit përmbaerues - aktvendimit të Doganës së Kosovës, Drejtoria Rajonale ZBD Pejë nr. protokolli 2387/1 – 02.5.1 të datës 26.02.2019, i formës së prerë nga data 30.05.2020 dhe i ekzekutueshëm nga data 30.06.2020.

Përmbaeruesi privat Kushtrim M. Musa, duke vepruar sipas propozimit për përmbaerim të kreditorit me urdhrin P.nr.222/2020 të datës 14.08.2020, ka lejuar përmbaerimin kundër debitorit në bazë të dokumentit përmbaerues - aktvendimit, duke vlerësuar se dokumenti përmbaerues i plotëson kushtet për përmbaerim.

Kundër këtij urdhri përmbaerimor debitori me datë 21.10.2020 ka paraqitur prapësim duke kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbaerimor, me arsyetimin se përmbaeruesi privat ka lejuar propozimin për përmbaerim në bazë të një dokumenti i cili nuk është titull ekzekutiv sepse të njëjtit i mungojnë vula e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë, çka nënkupton se i njëjti nuk është i përshtatshëm për ekzekutim, me propozim që të aprovohet prapësimi dhe të anulohet urdhri përmbaerimor.

Përgjigje në prapësim nuk ka paraqitur kreditori.

Gjykata Themelore në Pejë – Dega në Deçan, pas vlerësimit të prapësimi dhe provave që gjenden në shkresat e lëndës me aktvendimin EP.nr.69/2020 të datës 15.10.2021, ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit dhe ka lënë në fuqi urdhrin përmbaerimor P.nr.222/2020 të datës 14.08.2020. Kundër këtij aktvendimi ankesë ka paraqitur debitori, për të cilën ka vendosur Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, me aktvendimin K.DH.SH.II.nr.288/2022 të datës 23.08.2022, me të cilin ka aprovuar si të themeltë ankesën e debitorit dhe ka anuluar aktvendimin e ankimuar EP.nr.69/2020 të datës 15.10.2021, me arsyetimin se dokumenti përmbaerues – aktvendimi i Doganës së Kosovës, Drejtoria Rajonale ZBD Pejë nr. protokolli 2387/1 – 02.5.1 i datës 26.02.2019, nuk përmban vulën e plotfuqishmërisë dhe të ekzekutueshmërisë.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, në riprocedurë duke marr për bazë sugjerimet e dhomës së shkallës së dytë, me Konkluzionin KPPP.nr.2160/2022 të datës 22.03.2023 ka urdhëruar kreditorin që brenda afatit prej tri ditëve, t’ia dorëzoj gjykatës aktvendimin nr. protokolli 2387/1 – 02.5.1 të datës 26.02.2019, në origjinal dhe të kompletuar me vulën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë. Pala kreditore me datë 30.03.2023, brenda afatit ligjor të paraparë me konkluzionin KPPP.nr.2160/2022 të datës 22.03.2023, i ka dorëzuar dhomës së shkallës së parë dokumentin përmbaerues – aktvendimin e Doganës së Kosovës nr. protokolli 2387/1 – 02.5.1 i datës 26.02.2019, në origjinal dhe të kompletuar me vulën e plotfuqishmërisë dhe ekzekutueshmërisë.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë, pas shqyrtimi të shkresave të lëndës me aktvendimin KPPP.nr.2160/2022 të datës 31.03.2023, ka Refuzuar si të pabazuar prapësimin e debitorit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktvendimit të ankimuar, dhoma e shkallës së parë, ka theksuar se aktvendimi 02.5.1 i datës 26.02.2019, i ZBD Pejë, me nr. protokolli 2387, i nxjerrë nga kreditori në procedurë administrative, është i plotfuqishëm që nga data 30.05.2020 dhe i ekzekutueshëm që nga data 30.06.2020, dhe ka formën e rregullt të aktit që përmban të gjitha elementet e domosdoshme konform nenit 21, lidhur me nenin 22 paragrafi 1, pika 1.2, 23 paragrafi 2, 24 paragrafi 3 dhe neni 27 të LPP-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore, kur ka vendosur sipas prapësimin të debitorit të paraqitur kundër urdhrit të përmbartuesit privat, me të cilin është caktuar përmbartimi i propozuar nga kreditori. Edhe sipas vlerësimit të kësaj gjykate me shikimin në shkresat e lëndës qartë konstatohet se përmbartimi është lejuar në bazë të aktit administrativ i paraparë me nenin 22 paragrafi 1, pika 1.2 të LPP-së, si dokument përmbartues.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, dhoma e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur ka konstatuar se dokument përmbartues në rastin konkret paraqet akti administrativ i organit të administratës i nxjerr në pajtim me rregullat në atë procedurë siç parashihet me nenin 24 paragrafi 3 të LPP-së. Së këndejmi, edhe Dhoma e shkallës së dytë është e qëndrimit të njëjtë juridik se në procedurën përmbartimore organi përmbartues, përfshirë këtu edhe gjykatën që ka kompetencë shqyrtimin e ligjshmërisë së përmbartimit, nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e aktit administrativ të nxjerrë në procedurën e brendshme administrative. Andaj, organi përmbartues, përfshirë edhe gjykatën e shkallës së parë shqyrton vetëm rregullsinë dhe përshtatshmërinë e dokumentit përmbartues, me ç'rast procedura sipas prapësimin i nënshtrohet vetëm shqyrtimit formal të titullit ekzekutiv. Mirëpo, gjykata nuk ka tagër të vlerësojë ligjshmërinë e procedurës së brendshme administrative të zhvilluar para organit të administratës, përderisa vendimi i tillë përbën akt administrativ i cili cilësohet si dokument përmbartimor. Fakti se pala në procesin administrativ pretendon shkelje të asaj procedure, respektivisht nëse kreditori i ka zhvilluar apo jo rregullat e procedurës së brendshme administrative, janë objekt shqyrtimi brenda procedurave administrative apo mjeteve të tjera juridike për të vërtetuar ligjshmërinë apo kundërligjshmërinë e aktit administrativ. Ndërkaq, objekt i kësaj procedure është vetëm rregullsia formale e dokumentit përmbartimor, i cili edhe për Dhomën e shkallës së dytë paraqet dokument të përshtatshëm për përmbartim, konform dispozitave të nenit 24 paragrafi 3 dhe nenit 27 të LPP-së.

Bazuar ne këto arsye, Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se dhoma e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës ka marr vendim të drejtë dhe të bazuar në ligj dhe sipas kësaj gjykate aktvendimi i ankimuar nuk është marr me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe përmbartimore.

Sipas kësaj gjykate, aktvendimi i ankimuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) të LPK dhe në konstatim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Dytë i shqyrtuan pretendimet ankimore të debitorit, edhe sa i përket shkeljeve esenciale që ndërlidhen me mungesën e përshtatshmërisë së aktit administrativ në këtë procedurë përmbarrimore. Në këtë drejtim, gjykata rithekson se dokumenti përmbarrimor rrjedh nga akti administrativ i nxjerr nga kreditori në procedurë të brendshme, i cili në aspektin formal përmban të gjitha kushtet e parapara ligjore nga neni 27 paragrafi 1 i LPP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Dokumenti përmbarrimor është i përshtatshëm për përmbarrim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”*.

Në rastin konkret edhe Dhomat e shkallës së dytë vlerëson se qëndrimi i dhomës së shkallës së parë lidhur me kompetencën lëndore por edhe gjykimin e çështjes është i drejtë dhe në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike, pasi që akti administrativ përmban vulën e plotfuqishmërisë dhe përmbarrueshmërisë, i cili vendim është nxjerr konform autorizimeve ligjore të organit të administratës, ligjshmëria eventuale e të cilit mund t’i nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë në procedurën e konfliktit administrativ.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 paragrafi 1, pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.936/2023 me datë 30.01.2024

Gjyqtari,
Krenar Berisha